

26 Shtator

Dita Botërore e Kontracepsionit

Dita Botërore e Kontracepsionit është një fushatë globale e cila organizohet çdo vit më 26 shtator, dhe përqendrohet rreth vizionit ku çdo shtatzëni të jetë e dëshiruar.

Duke filluar që nga viti 2007, misioni i kësaj fushate globale është të përmirësojë ndërgjegjësimin mbi kontracepsionin, si dhe të mundësojë që çdokush të bëjë zgjedhje të informuara për shëndetin e tij seksual dhe riprodhues.

Promovimi i planifikimit familjar dhe sigurimi i qasjes në metodat kontraceptive të preferuara është thelbësor për sigurimin e mirëqenies dhe pavarësinë e grave, duke përkrahur shëndetin dhe zhvillimin e komuniteteve.

Mundësia e grave për të zgjedhur *nëse/kur/sa* fëmijë duan të kenë, siguron avancimin e objektivave globale shëndetësore, si dhe ul nivelin e varfërisë.

Për më tepër shiko: <http://www.ishp.gov.al/shendeti-riprodhues/>